



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim 1

Ngarkesa: 4 kredite (= 40 orë mësimore); 1.5 Kredite Leksion(= 15 orë mësimore); 2.5 Kredite seminar (= 25 orë mësimore)

Viti / Semestri : Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Gjuhë Angleze, Studime Britanike e Amerikane

Kodi i etikës: Kodi i etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore : Të njohë studentët me përkthimin si proces dhe si produkt, duke e lidhur atë me sistemin gjuhësor dhe kontekstin kulturor të gjuhëve angleze dhe shqipe. Të zhvillojë kompetencat shumëdisiplinore të studentëve në interpretimin dhe përkthimin e teksteve të shkruara dhe të folura. Të nxisë ndërgjegjësimin për rolin e përkthimit në komunikimin ndërkulturor dhe në procesin e të nxënit të gjuhës.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të trajtojë në mënyrë teorike dhe praktike dukuritë leksikore, gramatikore dhe stilistike të përkthimit anglisht-shqip dhe anasjelltas.
2. Të zhvillojë aftësinë për të analizuar dhe manipuluar tekste të stileve dhe zhanreve të ndryshme funksionale, me fokus te mediat.
3. Të aplikojë strategji për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve përkthimore në nivel mikro dhe makrotekstual.

Rezultatet e pritshme: Në përfundim të kursit, studenti pritët të jetë në gjendje të:

1. Të përkthejë në mënyrë të pavarur tekste autentike nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas, duke ruajtur funksionin dhe efektin e tekstit burimor.
2. Të aplikojë njohuritë gramatikore, leksikore dhe stilistike në përkthimin praktik të teksteve të nivelit mesatar dhe të avancuar.
3. Të integrojë njohuritë dhe aftësitë gjuhësore, kulturore dhe metodologjike për të përballuar kompleksitetin e përkthimit në fusha të ndryshme.